

**INSTITUTI I KURRIKULAVE DHE STANDARDEVE**

**PROGRAMI I GJUHËS SHQIPE**

**KLASA 6**

## Hyrje

Gjuha shqipe është lënda bazë në sistemin e edukimit parauniversitar në shkollën shqipe. Mësimi i gjuhës amtare duhet vlerësuar si çelësi i tërë suksesit dhe progresit të nxënësve. Ajo i jep çdo shkollari shanse për një ndjekje progresive të edukimit në të tëra nivelet e tij të edukimit.

Mësimi i gjuhës shqipe duhet vlerësuar si bazë në zhvillimin intelektual, emocional e social për nxënësit. Ai i aftëson nxënësit të komunikojnë me efektivitet për qëllime të ndryshme, duke zbuluar eksperiencat, ndjenjat dhe idetë e tyre dhe të të tjerëve, duke i dhënë kuptim të menduarit, nëpërmjet të folurit me gojë dhe me shkrim.

Gjuha që mësojnë dhe fitojnë nxënësit në fillim në shtëpi, më pas në kopshte dhe në shkolla, është pasqyrë e karakteristikave të të folurit të një kombi. Nxitja për të pasuruar eksperiencat gjuhësore, për t'i bërë ato më të pasura, më të këndshme dhe më të larmishme është detyrë e shkollës dhe e mësuesit, të cilët në tërë aktivitetin e tyre duhet t'ia drejtojnë vëmendjen këtij procesi.

Shkolla ka për detyrë të mbështesë nxënësit, për të njësuar mësimin e gjuhës amtare. Për këtë, nëpërmjet lëndës së gjuhës shqipe zhvillohen:

a- *Shprehi komunikative* të cilat realizojnë në tërësi aktin e komunikimit;

b- *Jepen dhe sistemohen njohuri* të caktuara për gjuhën shqipe dhe sistemin e saj gjuhësor;

Përmes shprehive komunikative (arteve apo linjave të të mësuarit të gjuhës shqipe në shkollë) synohet të aftësohen nxënësit:

- Për zhvillimin e *dëgjimit* të kujdesshëm.
- Për zhvillimin e *të folurit* saktë dhe me përpikmëri.
- Për zhvillimin e *të lexuarit* dhe të kuptuarit të tij.
- Për zhvillimin e *të shkruarit* standard të gjuhës dhe të modeleve të veta përfaqësuese.

## Synimi i mësimit të gjuhës amtare

**Mësimi i gjuhës amtare në shkollë, nisur nga objekti i vet si lëndë parësore dhe si lëndë më karakter të theksuar kombëtar, synon zhvillimin e përgjithshëm intelektual dhe komunikativ të çdo individi, për realizimin e të gjitha marrëdhënieve humane komunikative që realizohen përmes gjuhës.**

Mbështetur në formulimin e mësipërm, mësimi i gjuhës shqipe në shkollë synon:

- *T'i aftësojë nxënësit të komunikojnë për qëllime të ndryshme* me të tjerët, duke i dhënë kuptim të menduarit të tyre nëpërmjet *të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit*.
- *Të përvetësojnë gjuhën amtare në atë nivel e cilësi, që të mundësojë të mësuarin e tyre në mënyrë progresive për tërë jetën*, duke shprehur eksperiencat gjuhësore të pasura, të këndshme, të larmishme, si dhe duke shprehur imagjinatën dhe ndjenjat e tyre rreth dukurive të jetës dhe botës që i

rrethon, aftësi dhe qëndrime të pranueshme, në drejtim të zhvillimit të tyre gjuhësor, përfshirë këtu edhe marrëdhënie të tilla, si: **dialogun, tolerancën, lojën, bashkëpunimin.**

- *Të mundësojë rritjen dhe zhvillimin individual, emocional, estetik, social dhe moral të çdo nxënësi.*

## **OBJEKTIVA TË PËRGJITHSHME TË MËSIMIT TË GJUHËS AMTARE NË SHKOLLË**

Synimi i mësimi të gjuhës shqipe në klasën e gjashtë kërkon që nxënësi të arrijë objektivat e mëposhtme:

- *Të komunikojë* për qëllime të ndryshme me të tjerët, duke e përdorur gjuhën me korrektesi dhe duke transmetuar mendimet nëpërmjet *të folurit, të lexuarit e të shkruarit.*
- *Të përdorë dhe analizojë* sistemin gjuhësor të shqipes në nivelet e veta përfaqësuese: *drejtshqiptim, drejtshkrim, fjalëformim, morfosintaksë etj.*
- *Të përdorë* gjuhën amtare në atë nivel dhe cilësi që të mundësojë të mësuarit e tyre, në mënyrë të vazhdueshme gjatë gjithë jetës, duke fituar përvoja gjuhësore të pasura, të këndshme, të larmishme, si dhe duke shprehur imagjinatën dhe ndjenjat e tyre rreth dukurive të jetës dhe botës që i rrethon, duke shprehur aftësi pozitive dhe qëndrime të pranueshme për zhvillimin e tyre gjuhësor dhe intelektual, përfshirë këtu marrëdhënie të tilla, si: *dialogu, loja, toleranca dhe bashkëpunimi.*
- *Të rrisë* në mënyrë progresive dhe në përshtatje me moshën zhvillimin individual emocional, estetik, moral dhe shoqëror të nxënësve.
- *Të zhvillojë* mendimin e pavarur dhe kritik të nxënësve.
- *Të zhvillojë* ndërgjegjësimin e nxënësve për identitetin e tyre kulturor.
- *Të zhvillojë* një formim global të nxënësve rreth dukurive dhe problemeve të sotme të shoqërisë njerëzore.

Në mënyrë sintetike **OBJEKTIVAT** e mësipërme grupohen në:

- *Objektiva* për zhvillimin e personalitetit të nxënësve.
- *Objektiva* për zhvillim gjuhësor dhe letrar.
- *Objektiva* për ndërgjegjësimin ndaj identitetit kombëtar.
- *Objektiva* për zhvillimin në komunikim të tolerancës, respektit dhe diversitetit të shoqërisë njerëzore në vend dhe në kohëra të ndryshme.
- *Objektiva* për zhvillimin e mendimit të pavarur dhe kritik të nxënësve.

## **FUSHAT E STUDI MIT**

### **▪ Linjat dhe nënlinjat**

- *Të dëgjuarit*
- *Të folurit*
- *Të lexuarit*
- *Të shkruarit*
- *Njohuri rreth sistemit të gjuhës*

Në çdo linjë reflektohen komponentët e mëposhtëm:

- *Akti i komunikimit*
- *Programi tematik*
- *Lidhja e temave me funksionet gjuhësore*

## ▪ Objektivat për çdo fushë studimi

### **Të dëgjuarit**

- ◆ Të dëgjojë me vëmendje i vetëm dhe në grup;
- ◆ Të kuptojë atë që dëgjon;
- ◆ Të ndjekë bashkëbiseduesin për të pasur mundësi t'i përgjigjet atij;
- ◆ Të respektojë bashkëbiseduesin;
- ◆ Të marrë pjesë në bashkëbisedim;
- ◆ Të kuptojë tekstet e ndryshme për t'i përvetësuar ato;
- ◆ Të aftësohet për t'u përqëndruar në problemet thelbësore që dëgjon;
- ◆ Të reflektojë rreth materialeve që dëgjon;
- ◆ Të marrë informacion për ta përdorur kur i nevojitet etj.

### **Të folurit**

- ◆ Të marrë pjesë aktive në bashkëbisedim;
- ◆ Të përgjigjet për pyetjet që i bëhen;
- ◆ Të shprehë mendime, përvojë, ndjenja;
- ◆ Të shprehë mendime me synime të caktuara;
- ◆ Ta shprehë informacionin me shumëllojshmëri kontekstesh etj.

### **Të lexuarit**

- ◆ Të kuptojë materialin dhe të marrë informacion prej tij;
- ◆ Të pasurojë dijet dhe të zhvillojë ndjenjat e veta;
- ◆ Të zbulojë karakteret e personazheve;
- ◆ Të njohë gjini dhe lloje letrare;
- ◆ Të njohë idetë e pjesës që punohet dhe ndjenjat e shkrimtarit;
- ◆ Të zgjerojë njohuritë rreth gjuhës së veprave letrare;
- ◆ Të pasurojë të folurit nëpërmjet të lexuarit etj.

### **Të shkruarit**

Nëpërmjet kësaj linje synohet që nxënësi:

- ◆ Të njohë dhe të përdorë drejt strukturat gramatikore të shqipes;
- ◆ Të njohë dhe të fitojë aftësi dhe shprehi të drejtshkrimit të shqipes, si dhe të përdorë drejt pikësimin;
- ◆ Të shkruajë për qëllime të caktuara;
- ◆ Të shkruajë me modele të ndryshme të të shkruarit etj.

### **Njohuri rreth gjuhës dhe sistemit të saj gramatikor**

- ◆ Për të marrë dhe aplikuar njohuri dhe shprehi nga fusha e sintaksës;
- ◆ Për të marrë njohuri dhe shprehi nga fusha e morfologji dhe për t'i lidhur klasat e fjalëve me funksionet e tyre;

- ◆ Për të bërë analiza fjalëformuese;
- ◆ Për të pasuruar njohjet dhe përdorimin e dukurive leksikologjike;
- ◆ Për të pasur një kulturë gjuhe të përshtatshme për moshën;
- ◆ Për të respektuar një drejtshqiptim, drejtshkrim dhe pikësim korrekt të gjuhës shqipe.

### Struktura sintetike e programit

	Linja	Orë	Nënlinja	Orë
1.	Lexim	70 orë	▪ Letërsi shqipe dhe e huaj	70
			▪ Përralla	
			▪ Tregime	
			▪ Vjersha	
			▪ Folklor	
2.	Gjuhë e folur, gjuhë e shkruar	30 orë	Gjuhë e folur	14
			Gjuhë e shkruar	16
3.	Morfosintaksë	65 orë	▪ Sintaksë	22
			▪ Morfologji	22
			▪ Fjalëformim	4
			▪ Leksikologji	4
			▪ Kulturë gjuhe	3
			▪ Drejtshkrim	10
4.	Dispozicion	10 orë	▪ Testime	10
			▪ Përsëritje	

## ZBËRTHIMI I PËRMBAJTJES SË PROGRAMIT SIPAS LINJAVE, NËNLINJAVE, OBJEKTIVAVE DHE ARRITJEVE

### LINJA. Të dëgjuarit dhe të folurit (14 orë)

Nënlinjat	Përmbajtja	Objektivat	Rezultatet e pritshme
1. Të dëgjuarit e të folurit për të marrë informacion, udhëzime dhe orientime	<ul style="list-style-type: none"> <li>☞ Materiale të ndryshme që japin informacion nga fusha të ndryshme të veprimtarisë.</li> <li>☞ Materiale të ndryshme të incizuara, lexime nga libra me karakter kryesisht jo letrar guida, fletëpalosje, harta etj.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të ndjekë me vëmendje të tjerët ose informacionin që vjen nga burime të ndryshme TV, Radio, Video etj.</li> <li>• Të tregojë interes dhe të respektojë tjetrin gjatë të folurit.</li> <li>• Të interpretojë informacionin e marrë.</li> <li>• Të japë këshilla instruksione etj.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Ndjekje me vëmendje e informacionit që sjellin të tjerët.</li> <li>▪ Shkëmbim informacioni nga fusha të ndryshme të veprimtarisë.</li> <li>▪ Interpretim i informacionit të marrë.</li> <li>▪ Dhënie këshillash, udhëzimesh, orientimesh etj.</li> </ul>
2. Të dëgjuarit dhe të folurit në grup	<ul style="list-style-type: none"> <li>☞ Situata të ndryshme me tematikë nga veprimtaria e përditshme dhe me tema të tjera të rëndësishme.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të familjarizohet me të dëgjuarin dhe të folurin në grup.</li> <li>• Të dallojë çështje që lidhen me temën që diskutohet.</li> <li>• Të ofrojë opsione alternative.</li> <li>• Të përdorë gjuhë të përshtatshme dhe me terminologji të zgjedhur.</li> <li>• Të ndjekë ose të ndryshojë linjën e argumenteve.</li> <li>• Të respektojë pika kyç të diskutimit në grup.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Të respektojë anëtarët e tjerë të grupit.</li> <li>▪ Dallim i çështjeve që lidhen me temën për të cilën diskutohet.</li> <li>▪ Gjetje zgjidhjesh alternative.</li> <li>▪ Përdorim i një gjuhe të përshtatshme dhe me terminologji të zgjedhur.</li> <li>▪ Raste të ndryshimit të linjës së argumenteve.</li> <li>▪ Respektim i pikave kyç të diskutimit në grup.</li> </ul>
3. Të dëgjuarit dhe të folurit rreth teksteve të ndryshme	<ul style="list-style-type: none"> <li>☞ Situata reale komunikimi që kanë të bëjnë me eksperiencat të ndryshme, me ndjenja dhe opinione të shprehura për çështje të ndryshme të cilat zgjidhen edhe nga leximet dhe</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të shprehin përvoja vetiake për probleme të ndryshme.</li> <li>• -Të japin opinione rreth përvojave të shprehura prej të tjerëve.</li> <li>• -Të shprehin ndjenjë dhe emocione gjatë të treguarit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ -Shprehin përvoja vetiake për probleme të ndryshme.</li> <li>▪ -Japin opinione rreth përvojave të shprehura prej të tjerëve.</li> <li>▪ -Shprehin ndjenjë dhe emocione gjatë të treguarit .</li> </ul>

	përvojat vetjake.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• -Të dinë si ta shprehin idenë si të organizojnë diskutimin.</li> <li>• Të përdorin pyetjet kush ? kur?ku?si?sa?</li> <li>• -Të pyesin për detaje shtesë.</li> <li>• -Të bëjnë hyrje, zhvillim, mbyllje të përvojave që tregojnë.</li> <li>• -Të shoqërojnë të folurin e tyre më zheste verbale dhe joverbale.</li> <li>• -Të kontribuojnë në situata për zgjidhje konflikti.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ -Dinë si ta shprehin idenë, si të organizojnë diskutimin.</li> <li>▪ -Përdorin pyetjet: <i>Kush ? Kur?Ku?Si?Sa?</i></li> <li>▪ -Pyesin për detaje shtesë.</li> <li>▪ -Bëjnë <i>hyrje zhvillim mbyllje</i> tregimeve rreth të përvojave që tregojnë.</li> <li>▪ -Shoqërojnë të folurin e tyre më zheste verbale dhe joverbale</li> <li>▪ -Reflektojnë rreth qëndrimeve konfliktuoze.</li> </ul>
4. Të dëgjuarit dhe të folurit e llojeve dhe gjinive letrare	☞ Tekste të ndryshme letrare dhe jo letrare në të cilat analizohet: struktura, elementet e saj dhe tregues të tjerë formalë.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të dallojë në histori të ndryshme elementet formalë dhe gjuhësorë që i dallojnë ato nga llojet e tjera.</li> <li>• Të dallojë në poezi elemente që i dallojnë ato nga proza, si: vargu, rima etj.</li> <li>• Të njohë struktura të teksteve të tipit intervistë, reportazh, skicë, raport, informacion i shkurtër etj.</li> <li>• Të identifikojë ndryshimet mes skeleteve të ndryshme të teksteve letrare dhe jo letrare.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dallimi i elementeve formale dhe gjuhësore në tekste të ndryshme.</li> <li>▪ Dallimi në poezi i elementeve të tilla, si: <i>vargu, rima etj.</i></li> <li>▪ Njohja me struktura të teksteve të tipit intervistë, reportazh, skicë, raport, informacion i shkurtër etj.</li> <li>▪ Identifikimi i ndryshimeve ndërmjet skeleteve të teksteve letrare dhe joletrare.</li> </ul>
5. Njohuri rreth gjuhës standarde shqipe	☞ Gjuha standarde shqipe dhe dialektet janë tema të rëndësishme për të cilat mund të diskutohet dhe të mbahen qëndrime rreth respektimit dhe	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të diskutojë rreth standardit të gjuhës shqipe.</li> <li>• Të njohë dialektet dhe diferencat midis tyre.</li> <li>• Të vlerësojë gjuhën e masmedias dhe të</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Fitim njohurish rreth gjuhës standarde shqipe.</li> <li>▪ Evidentimi i ndryshimeve mes dialekteve të shqipes.</li> <li>▪ Vlerësim i gjuhës së masmedias dhe</li> </ul>

jo të normës së saj.	teksteve të tipit letrar dhe jo letrar.	të teksteve të tipit letrar dhe jo letrar.
----------------------	---	--

### LINJA: Të lexuarit (70 Orë)

Nënlinjat	Përmbajtja	Objektivat	Rezultatet e pritshme
1. Të lexuarit për të kuptuar pjesën e për të marrë informacion	<ul style="list-style-type: none"> <li>☞ Broshura, libra të vegjël, orare, fletëpalosje, guida.</li> <li>☞ Burime të larmishme referencash.</li> <li>☞ Materiale të shoqëruara me grafikë, matrica, diagrama, ilustrime etj.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të lexojë me kuptim duke e marrë informacionin dhe duke e shpjeguar atë.</li> <li>• Të lexojë në përshtatje me llojin e tekstit duke respektuar intonacionin, shenjat e pikësimit etj.</li> <li>• Të vlerësojë tekstet që lexojnë.</li> <li>• Të shpjegojë grafikët, tabelat, pikturat e shenja të tjera me të cilat shoqërohen tekstet.</li> <li>• Të lexojë artikuj që kanë të bëjnë me informacione nga fusha të ndryshme <i>shëndetësi, mjedis, sport, barazi gjinore, të drejtat e fëmijëve</i> etj.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Të kuptuarit e teksteve të llojeve të ndryshme letrare dhe joletrare.</li> <li>▪ Marrje informacioni të natyrave të ndryshme.</li> <li>▪ Shpjegim dhe interpretim i informacionit të marrë.</li> <li>▪ Shpjegim i hartave, diagrameve, figurave, pikturave etj.</li> <li>▪ Vlerësim i problemeve dhe temave të lexuara.</li> <li>▪ Krahasim i shkrimeve informative të tipeve të ndryshme.</li> </ul>
2. Të lexuarit për dëshirë dhe për zhvillimin e ndjenjave	<ul style="list-style-type: none"> <li>☞ Tekste të llojit letrar të niveleve të arrira përfaqësuese të letërsisë shqiptare dhe asaj botërore të periudhave të ndryshme.</li> <li>☞ Poezi</li> <li>☞ Biografi e</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të lexojë në mënyrë artistike dhe me ndjenjë.</li> <li>• Të kultivojë ndjenjën për të lexuar.</li> <li>• Të lexojë duke iu përgjigjur interesave dhe dëshirave të tyre.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Lexim për interesa vetjake.</li> <li>▪ Shprehje e pëlqimit ose jo për pjesët e lexuara</li> <li>▪ Shprehje e dëshirave specifike rreth llojeve e stileve të pjesëve që lexon.</li> <li>▪ Lexim e dramatizim i pjesëve që lexon.</li> </ul>



	shkrimtarëve të njohur		
3. Të lexuarit për të reflektuar mbi idetë e pjesës	☞ Vepra të letërsisë shqiptare dhe të letërsisë botërore të periudhave të ndryshme dhe të përshtashme për këtë moshë.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të lexojë tekste të llojeve të ndryshme letrare e jo letrare, si: poezi prozë, dramë, artikuj gazete etj.</li> <li>• Të lexojë qartë dhe me shqiptim të saktë.</li> <li>• Të bëjë analiza gjuhësore dhe letrare për pjesë dhe fragmente të ndryshme.</li> <li>• Të dallojë tekste letrare dhe joletrare.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Lexim i llojeve dhe gjinive të ndryshme letrare.</li> <li>▪ Evidentimi i elementeve që përbëjnë veçoritë e një lloji a gjinie.</li> <li>▪ Analizim i fragmentit të lexuar.</li> <li>▪ Krahasim i stileve të shkrimtarëve.</li> <li>▪ Vlerësim i karaktereve, ngjarjeve, konflikteve, marrëdhëniet e brendshme, përmbajtjen.</li> <li>▪ Njohje e gjuhës dhe stilit të shkrimtarit.</li> <li>▪ Opinione për veprat e autorëve të ndryshëm.</li> </ul>
4. Të lexuarit e llojeve dhe gjinive letrare	<ul style="list-style-type: none"> <li>☞ Tekste të tipeve të ndryshme, si: poemë, poezi dramë, tregim etj.</li> <li>☞ Tekste të tipit informativ për të bërë krahasime midis teksteve të tipit letrar dhe atyre jo letrar.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të njihet me gjinitë dhe llojet letrare.</li> <li>• Të kuptojë ndryshimet mes llojeve dhe gjinive letrare.</li> <li>• Të përshtatet gjatë leximit me mënyrën specifike të leximit të llojeve dhe gjinive letrare</li> <li>• Të krahasojë tekstet letrare dhe ato jo letrare.</li> <li>• Të analizojë subjektin dhe përmbajtjen e teksteve të ndryshme.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Njohje e gjinive dhe llojeve letrare, si: <i>prozë, poezi dhe dramë</i> dhe e karakteristikave të tyre.</li> <li>▪ Evidentimi i elementeve diferencuese të llojeve dhe stileve të mësipërme.</li> <li>▪ Analizimin i subjektit dhe i përmbajtjes së teksteve të ndryshme.</li> <li>▪ Komentim i ideve dhe motiveve që përcjellin veprat.</li> <li>▪ Analizë e treguesve gjuhësorë që i japin shkrimeve vlera artistike, figura të thjeshta etj.</li> </ul>
5. Të lexuarit me zë të lartë dhe në heshtje	<ul style="list-style-type: none"> <li>☞ Pjesë të incizuara</li> <li>☞ Tekste dramatike që janë të mundshme për t'u dramatizuar dhe luajtur në role nga nxënësit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të lexojë me zë të lartë, saktë dhe me intonacionin e duhur.</li> <li>• Të interpretojë pjesë letrare të llojeve të ndryshme.</li> <li>• Të mësojë përmendësh pjesë në poezi dhe në prozë.</li> <li>• Të interpretojë në grupe të vogla dhe</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Lexim pjesësh me zë të lartë, saktë dhe me intonacionin e duhur.</li> <li>▪ Interpretim i teksteve të llojeve të ndryshme me intonacionin e duhur.</li> <li>▪ Recitim përmendësh i pjesëve në poezi dhe në prozë.</li> <li>▪ Dramatizim i pjesëve të ndryshme.</li> </ul>

		në grupe të mëdha.	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Interpretim rolesh e monologesh sipas preferencave të nxënësve.</li> </ul>
6. Njohuri rreth gjuhës standarde shqipe	<ul style="list-style-type: none"> <li>☞ Tema, karakteret, vendosja e marrëdhënieve, motivet, idetë, plani i pjesës janë terma që do t'i shtohen tashmë analizave të nxënësve në lidhje me tekstet që lexojnë.</li> <li>☞ Faktet, opinionet, vlerësimi, argumenti janë terma të reja që do të zënë vend në këtë nivel.</li> <li>☞ Terma, si: <i>layout</i>, <i>bold</i>, <i>italik</i>, të cilat janë orientuese, shpjeguese dhe informuese.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të respektojë gjatë të lexuarit rregullat e drejtshqiptimit të strukturave morfologjike.</li> <li>• Të pasurojë fjalorin me fjalë dhe shprehje të reja të fushave të veprimtarisë sipas tematikës së rekomanduar nga pjesët që lexohen.</li> <li>• Të përdorë fjalorë për shpjegimin e fjalëve të vështira dhe të panjohura.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Lexim dhe interpretim duke respektuar shenjat e pikësimit dhe të shqiptimit të fjalëve.</li> <li>▪ Përdorim i termave: <i>subjekt</i>, <i>strukturë</i>, <i>motiv</i>, <i>mesazh</i>, <i>karakter</i>, <i>personazh</i>, <i>gjini</i>, <i>lloj</i>.</li> <li>▪ Përdorim fjalori, skeda shpjeguese etj.</li> <li>▪ Dhënie vlerësimesh për mënyrën se si janë shkruar veprat letrare, formën dhe gjuhën e përdorur.</li> </ul>

#### LINJA: Të shkruarit (16 Orë)

Nënlinjat	Përmbajtja	Objektivat	Rezultatet e pritshme
1. Të shkruarit funksional	☞ Lloje dhe modele shkrimi të të shkruarit tilla, si :	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të shprehë eksperiencat e tij për qëllime të ndryshme të shkruarit.</li> <li>• Të shfaqë aftësi për të shkruar në një</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Shprehje e përvojave personale për qëllime të ndryshme.</li> <li>▪ Aftësi për të shkruar në një variacion</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>udhëzime, njoftime, këshilla prezantimi;</i></li> <li>- <i>intervista, porosi, artikuj për gazeta muri, fjalëkryqe, ese, lojëra me kompjuter etj.</i></li> </ul>	<p>variacion qëllimesh dhe modelesh shkrimi.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• -Të shkruajë për një gjerësi lexuesish: për mësuesin, për prindërit, për shokët; për gazetën e klasës dhe të shkollës, për komunitetin etj.</li> <li>• Të shkruajë për t'iu përgjigjur një fushe të gjerë aktivitetesh të shkruari të tilla, si: <i>këshilla, njoftime, plane pune, udhëzime, njoftime, orientime.</i></li> <li>• Të shkruajë për të dhënë informacion për të tjerët nëpërmjet <i>udhëzimeve, argumentimit, përshkrimit, perifrimit etj.</i></li> </ul>	<p>qëllimesh dhe modelesh të shkruari.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Shkrime për një gjerësi lexuesish, për gazetën e klasës dhe të shkollës, për komunitetin etj.</li> <li>▪ Shkrime të një fushe të gjerë aktivitetesh të shkruari të tilla, si: <i>këshilla, njoftime, plane pune, ditare, argumentime, udhëzime, përshkrim përvojash, perifrimit të ndryshme etj.</i></li> </ul>
2. Të shkruarit personal (për nevoja vetjake)	<ul style="list-style-type: none"> <li>☞ Forma të tilla të shkruari, si: <i>letrat formale dhe personale, shënime, ditar etj.</i></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të zhvillojë stilin e tij personal nëpërmjet përdorimit të shenjave dhe strukturave të caktuara standarte të gjuhës standarde.</li> <li>• Të shkruajë duke përdorur imagjinatën e tij.</li> <li>• Të shkruajë shkrime personale, si <i>urime, shënime, njoftime, ditar etj.</i></li> <li>• Të shprehë ndjenja dhe interesa.</li> <li>• Të përshkruajë përvoja vetjake, si dhe aktivitete të kryera në grup.</li> <li>• Të shkruajë në mënyrë estetike me ndjenjë dhe me imagjinatë.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Zhvillim i stilit personal.</li> <li>▪ Shkrime personale, si: <i>urime, shënime njoftime, ditar etj.</i></li> <li>▪ Shkrimi i përvojave personale, si dhe aktivitete të kryera në grup.</li> </ul>
3. Të shkruarit me ndjenjë dhe imagjinatë	<ul style="list-style-type: none"> <li>☞ Histori të reja nga bota, hapësira reale dhe jo reale të shfaqura në TV, Video, Radio etj.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të shkruajë duke përdorur imagjinatën e tij.</li> <li>• Të përshkruajë heronjtë e tij imagjinarë.</li> <li>• Të argumentojë me imagjinatë rreth figurave të tilla, si: alienët, dinozaurët, fenomeneve natyrore, dhe zbulimeve të shkencës e teknikës.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Shkrime me ndjenjë e imagjinatë.</li> <li>▪ Përshkrim i hollësishëm i heronjve imagjinarë dhe i fenomeneve të natyrës.</li> <li>▪ Argumentime të imagjinatës së shfaqur.</li> <li>▪ Përshkrim me imagjinatë i personazheve, ngjarjeve, fenomeneve të</li> </ul>

		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të parashikojë zgjidhje.</li> <li>• Të gjejë mbyllje tregimesh sipas imagjinatës së tij.</li> </ul>	<p>natyrës dhe zbulimeve të reja.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Parashikimi u zgjidhjeve të mundshme.</li> <li>▪ Gjetje të reja të mbylljeve të tregimeve sipas imagjinatës.</li> </ul>
4. Njohuri rreth gjuhës	☞ Terminologji gjuhësore, si: paragrafi mbiemrat, ndajfoljet, lidhëzat dhe fjalë të tjera me kuptime dhe ndihmëse duhet të rimerren e të vlerësohen për mënyrën e përdorimit gjatë të shkruarit.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të përdorë saktë zanoret, bashkëtingëlloret mbiemrin, ndajfoljen, lidhëzat.</li> <li>• Të përfaqësohen më dendur shkrimet e nxënëve, klasat e fjalëve të mësipërme për t'i dhënë pasuri dhe bukuri gjuhës së tyre të shkruar.</li> <li>• Të respektohet gjinia, numri e kategori të tjera gramatikore gjatë shkrimit të fjalëve, të cilat tashmë duhet të jenë në larminë e trajtave të tyre.</li> <li>• Të respektohet paragrafi si kërkesë e rëndësishme në shkrime të tipeve të ndryshme.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dallimi i mbiemrit, ndajfoljes, i lidhëzave.</li> <li>▪ Respektimi i gjinisë, numrit dhe i kategorive të tjera gramatikore të fjalëve.</li> <li>▪ Respektim i paragrafit gjatë shkrimeve të tipeve të ndryshme.</li> </ul>

#### LINJA 4. Njohuri rreth gjuhës dhe sistemit të saj gramatikor

Nënlinjat	Përmbajtja	Objektivat	Rezultatet e pritshme
Sintaksa	<ul style="list-style-type: none"> <li>☞ Fjalë, përbërësit, funksionet</li> <li>☞ Fjalë e thjeshtë; grupi emëror, grupi foljor</li> <li>☞ Fjalitë sipas intonacionit të thënies.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të dallojë grupet e fjalëve që marrin pjesë në formimin e fjalisë</li> <li>• Të gjejë grupin emëror dhe grupin foljor në fjali.</li> <li>• Të identifikojë fjalitë duke u nisur nga intonacioni i thënies së tyre.</li> <li>• Të gjejë kryefjalën e shprehur me emër dhe përemër, si dhe lidhjet e saj me</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dallimi i grupeve të fjalëve që marrin pjesë në formimin e fjalisë.</li> <li>▪ Gjetje e grupit emëror dhe të grupit foljor në fjali.</li> <li>▪ Gjetja e llojit të fjalisë duke u nisur nga intonacioni i thënies së tyre.</li> <li>▪ Gjetja e kryefjalës së shprehur me emër dhe përemër dhe i lidhjeve të saj me foljen.</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>☞ Fjalja e thjeshtë dhe e përbërë.</li> <li>☞ Kryefjala</li> <li>☞ Kallëzuesi</li> <li>☞ Përcaktori</li> <li>☞ Kundrinori</li> <li>☞ Rrethanori</li> </ul>	<p>foljen.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të njihet me mënyrat e shprehjes së kallëzuesit.</li> <li>• Të dallojë kundinorët e të gjitha llojeve.</li> <li>• Të dallojë përcaktorin sipas llojeve të tij.</li> <li>• Të dallojë të gjithë llojet e rrethanorëve.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Përdorimi i kallëzuesit në të gjitha mënyrat e shfaqjes së tij.</li> <li>▪ Dallimi i të gjitha llojeve të përcaktorit.</li> <li>▪ Përdorimi i të gjitha llojeve të rrethanorit.</li> </ul>
Morfologjia	<ul style="list-style-type: none"> <li>☞ Klasat e fjalëve; grupi emëror</li> <li>☞ Emri; veçoritë gramatikore</li> <li>☞ Përcaktuesit e emrit</li> <li>☞ Mbiemri</li> <li>☞ Përemri vetor dhe pronor</li> <li>☞ Folja, zgjedhimi, mënyrat dhe kohët e saj</li> <li>☞ Lidhëzat</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të njohë klasat e fjalëve.</li> <li>• Të dallojë emrin dhe veçoritë e tij gramatikore.</li> <li>• Të njohë e të dallojë përcaktuesit e emrit.</li> <li>• Të dallojë mbiemrin dhe veçoritë e tij gramatikore.</li> <li>• Të dallojë përemrin vetor dhe pronor, si dhe veçoritë e tyre gramatikore.</li> <li>• Të zgjedhë foljen në të gjitha mënyrat dhe kohët e saj.</li> <li>• Të dallojë lidhëzat sipas llojet e tyre.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dallimi i emrit dhe i veçorive të tij gramatikore: gjininë, numrin, rasën, trajtën.</li> <li>▪ Dallimi i përcaktorëve të emrit..</li> <li>▪ Dallimi i mbiemrit dhe i veçorive të tij gramatikore: gjininë, numrin, llojin, rasën.</li> <li>▪ Dallimi i përemrit vetor e pronor dhe i veçorive të tyre gramatikore: gjininë, numrin, vetën.</li> <li>▪ Zgjedhimi i foljeve në të gjitha mënyrat dhe kohët.</li> <li>▪ Përdorimi i llojeve të ndryshme të lidhëzave.</li> </ul>
Fjalëformimi	<ul style="list-style-type: none"> <li>☞ Fjala dhe përbërësit e saj</li> <li>☞ Parashtesat e prapashtesat</li> <li>☞ Fjalët e prejardhura</li> <li>☞ Fjalët e përbëra</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të analizojë fjalën sipas përbërësve të saj.</li> <li>• Të dallojë parashtesat dhe prapashtesat dhe të krijojë fjalë të prejardhura prej tyre.</li> <li>• Të krijojë fjalë të përbëra.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Gjetja e përbërësve të fjalës.</li> <li>▪ Njohja me parashtesa e prapashtesa të ndryshme.</li> <li>▪ Përdorimi i tyre në formimin e fjalëve të prejardhura.</li> <li>▪ Krijimi i fjalëve të përbëra.</li> </ul>
Leksikologjia	<ul style="list-style-type: none"> <li>☞ Fusha leksikore e fjalëve</li> <li>☞ Kuptimi i parë dhe i figurshëm i fjalëve</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të njohë fushat semantike të fjalëve</li> <li>• Të dallojë kuptimin e aprë të fjalëve dhe kuptimin e figurshëm.</li> <li>• Të krijojnë familje fjalësh</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Gjetja e fushave leksikore të fjalëve.</li> <li>▪ Gjetja dhe shpjegimi i kuptimeve të figurshme të fjalëve.</li> <li>▪ Krijimi i familjeve me fjalë të ndryshme.</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>☞ Familja e fjalëve</li> <li>☞ Sinonimet dhe antonimet</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të gjejë e të dallojë fjalë sinonime dhe antonime</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Gjetja e sinonimeve dhe e antonimeve për fjalë të ndryshme.</li> </ul>
Kultura e gjuhës	<ul style="list-style-type: none"> <li>☞ Komunikimi dhe gjuha</li> <li>☞ Përdorimi fjalorëve</li> <li>☞ Fjalët e huaja</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të njohë funksionet e komunikimit.</li> <li>• Të njohë shenjat konvencionale në komunikim.</li> <li>• Të dallojë dialektet e shqipes.</li> <li>• Të dallojë fjalën shqipe nga fjala e huaj.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Njohja e funksioneve të komunikimit.</li> <li>▪ Njohja e përdorimi i shenjave konvencionale në komunikim.</li> <li>▪ Dallimi i dialekteve të shqipes nga njëri-tjetri.</li> <li>▪ Zëvendësimi i fjalës së huaj me fjalën përkatëse shqipe.</li> </ul>
Drejshqiptimi, drejtshkrimi, pikësimi	<ul style="list-style-type: none"> <li>☞ Drejtshkrimi i fjalëve me <i>e</i> të theksuar e të patheksuar.</li> <li>☞ Drejtshkrimi i fjalëve me <i>ë</i> të theksuar dhe me <i>ë</i> të patheksuar; <i>ë</i>-ja pastheksore; <i>ë</i>-ja fundore</li> <li>☞ Drejtshkrimi zanoreve: u, i-y, u-y, ie-je.</li> <li>☞ Grupet ye, ua, ue</li> <li>☞ Takimi i zanoreve të njëjta.</li> <li>☞ Apostrofi dhe theksi.</li> <li>☞ Përdorimi i: -, ”, !, ?, ( ).</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të shqiptojë dhe të shkruajë saktë fjalët e gjuhës shqipe</li> <li>• Të shkruajë saktë fjalët që e kanë shkronjën <b>e</b> në pozicione të ndryshme.</li> <li>• Të shkruajë saktë fjalët që e kanë shkronjën <b>ë</b> në pozicione të ndryshme.</li> <li>• Të shkruajë drejt fjalët që përmbajnë grupet e zanoreve: u, i-y, u-y, ie-je.</li> <li>• Të shkruajë drejt fjalët që përmbajnë grupet e zanoreve: ye, ua, ue.</li> <li>• Të përdorë drejt apostrofin.</li> <li>• Të shqiptojë saktë fjalët dhe me theksin e duhur.</li> <li>• Të përdorë drejt shenja pikësimi të tilla, si: -, ”, !, ?, ( ).</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Drejtshqiptim i të gjitha fjalëve të gjuhës shqipe.</li> <li>▪ Drejtshkrimi i fjalëve që e kanë shkronjën <b>e</b> në pozicione të ndryshme.</li> <li>▪ Drejtshkrimi i fjalëve që e kanë shkronjën <b>ë</b> në pozicione të ndryshme.</li> <li>• Drejtshkrimi i fjalëve që përmbajnë grupet e zanoreve: u, i-y, u-y, ie-je.</li> <li>▪ Drejtshkrimi i fjalëve që përmbajnë grupet e zanoreve: ye,ua,ue</li> <li>▪ Përdorimi i saktë i apostrofit</li> <li>▪ Përdorimi i saktë, siaps rastit i shenjave të tilla të pikësimit, si: -, ”, !, ?, ( ).</li> </ul>

## UDHËZIME METODOLOGJIKE

### PARIME DHE KRITERE

Për të realizuar synimet e mësipërme, ndihet e nevojshme të njihen dhe të respektohen parimet e mëposhtme:

#### A. Parime të përgjithshme

- Mësimi i gjuhës shqipe duhet të ruajë dhe të respektojë karakterin kombëtar.
- Mësimi i gjuhës amtare duhet të ruajë nga tradita elementet më progresive, duke i bashkuar ato edhe me elemente dhe komponentë të rinj kurrikularë.
- Mësimi i gjuhës amtare duhet të reflektojë identitetin kulturor, duke e krahasuar edhe me kulturat e vendeve fqinje.
- Mësimi i gjuhës shqipe duhet të kontribuojë në formimin e përgjithshëm intelektual të çdo individi.
- Mësimi i gjuhës shqipe duhet të kontribuojë në krijimin e marrëdhënieve humane midis njerëzve.
- Mësimi i gjuhës shqipe duhet të reflektojë dimensionet e sotme të zhvillimit të shoqërisë njerëzore.

#### B. Parime shkencore

- Mësimi i gjuhës amtare duhet të lidhet ngushtësisht me të gjitha shprehjet komunikative.
- Mësimi i gjuhës amtare duhet të mbështetet në modelet më të mira të fjalës së dëgjuar, të folur, të lexuar e të shkruar, të gjuhës që zhvillohet në procesin e vet të gjallë.
- Mësimi i gjuhës amtare duhet të përcjellë zhvillimet e reja të gjuhës dhe të ligjeve të zhvillimit të saj të brendshëm e të jashtëm.
- Njohuritë mbi sistemin gramatikor të gjuhës shqipe të jenë të qarta pa mbingarkesa.
- Të respektohet parimi i përfaqësimit të niveleve gjuhësore sipas specifikave që kanë.
- Parimi morfosintaksor të fillojë të respektohet atëherë kur nxënësi kanë njohje të mira mbi klasat e fjalëve dhe funksionet e tyre sintaksore.

#### C. Parime didaktike

- Mësimi i gjuhës shqipe lipset të përfshijë në përmbajtjen e vet elemente të zhvillimeve të sotme të didaktikës bashkëkohore.
- Në qendër të mësimin të gjuhës shqipe të qëndrojë parimi i zhvillimit të mendimit kritik gjatë të lexuarit e të shkruarit.
- Mësimi i gjuhës shqipe duhet të jetë në qendër të zhvillimit dhe përdorimit të metodave të reja të didaktikës bashkëkohore.
- Mësimi i gjuhës shqipe duhet të zhvillohet nëpërmjet përdorimit të materialeve autentike (të riciklueshme), përfshirë këtu materiale të medias së shkruar dhe të folur, televizionin, radion, kompjuterin etj.
- Mësimi i gjuhës shqipe duhet të zhvillohet në mënyrë të tillë, që ta shohë nxënësin në qendër të procesit mësimor dhe t'i lejojë atij të drejta të plota për pjesëmarrje me përvojat jetësore që ai zotëron.

- Mësimi i gjuhës shqipe duhet t'i lejojë mësuesit e gjuhës të shpalosin metoda dhe materiale mësimore të gjetura, të mbështetura në literaturë apo të krijuara prej tyre, për qëllime të rëndësishme të mësimit të gjuhës amtare në shkollë.
- Mësimi i gjuhës shqipe duhet parë si një mundësi e shoqërimit të nxënësve në tërë vitet e arsimit parauniversitar të tyre.

## **UDHËZIME PËR PËRFAQËSIMIN E PJESËVE LETRARE DHE JO LETRARE**

Programi i gjuhës shqipe, klasa 6, në fushën e të lexuarit letrare rekomandon:

### **a- Përfshirjen e pjesëve letrare që mbulojnë:**

- Folklorin
- Letërsinë shqiptare
- Letërsinë botërore (të periudhave të ndryshme)

### **b- Forma pune që do të përdoren gjatë orëve të leximit:**

- Lexim dhe analizë e teksti
- Leximet jashtë klase
- Recitimet, dramatizimi
- Shkrime të tipit ese me karakter letrar

## **UDHËZIME PËR CILËSINË E TË LEXUARIT**

- Kërkohet të përmirësohet cilësia, kuptimësia dhe shpejtësia e të lexuarit.
- Kërkohet që nxënësit të lexojnë me ndjenjë.
- Bisedat dhe leximet jashtëklase do të orientohen dhe do të zgjidhen nga vetë shkolla dhe mësuesit.
- Në këtë nivel shkollimi nxënësit duhet të lexojnë deri në 800 faqe.
- Kërkohet të bëhen nga nxënësit plane pjesësh.
- Të analizohen figura personazhesh.
- Nga teoria e letërsisë kërkohet që nxënësit të dallojnë disa nga figurat bazë: metaforën, epitetin, hiperbolën, elemente të thjeshta të vargëzimit
- Ushtrime dhe detyra me shkrim të tipit: shkrim i lirë, ese etj., duhet të shoqërojnë orët e mësimit ku të shkrihen e të ndërthuren shprehitë komunikative të të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit.

## **INTEGRIMI OSE LIDHJA NDËRLËNDORE**

Gjuha shqipe është mjet komunikimi për të gjitha lëndët. Lidhje të drejtpërdrejta ajo krijon me historinë, gjeografinë, artin dhe edukatën qytetare.

Lidhja dhe integrimi i programit të kësaj lënde me shumë komponentë të lëndëve të mësipërme i jep kësaj lënde më shumë frymëmarrje dhe zhvillim.

Kështu, rekomandohet që këto lidhje të vendosen që në hapat e para kur hartohet teksti dhe më pas të vijojë edhe gjatë mësimdhënies.

Aspekt i rëndësishëm i integrimit është edhe integrimi apo bashkëveprimi i vazhdueshëm i shprehive bazë komunikuese.



Asnjëherë ne nuk mund të bëjnë veprimtari të tilla të pastra, si: vetëm lexim, vetëm të folur apo vetëm të shkruar.

Të tëra këro rrjedhojnë nga njëra-tjetra dhe zhvillohen së bashku.

Një lidhje e fortë midis këtyre shprehive forcon cilësinë e të nxënësve.

## **VLERËSIMI**

Vlerësimi i nxënësve është një nga momentet më të rëndësishme të mësimin të gjuhës shqipe në shkollë. Praktika të reja kanë ardhur dhe vazhdojnë të vijnë për këtë qëllim në shkollën shqiptare. Gjithësesi, njohja, përshtatja dhe përdorimi i formave të reja të vlerësimit është një proces i cili shoqëron draftin e kurrikulit të gjuhës amtare. Kështu, është përpunuar koncepti i punës me standarde, të cilat sa mundësojnë për një përmbajtje cilësore të kurrikulit shkollor, aq përcaktojnë dhe japin impakt të drejtpërdrejtë në njohjen dhe vlerësimin e përmbajtjes shkollore në tërësi dhe për nxënësit në veçanti.

Standardet e përmbajtjes dhe standardet e arritjes përcaktojnë atë se çfarë duhet të dijë dhe të bëjë nxënësi në një nivel shkollimi, tregojnë atë që ka arritur nxënësi në këtë nivel.

Praktika e përdorimit të testit mësimor është një tjetër formë, e cila tashmë ka një kuptim të qartë si nga mësuesi, dhe nga nxënësit. Edhe pse nuk njihen ende mirë kriteret për hartimin dhe përdorimin e tyre, praktika e testit duket se ka vënë në lëvizje vlerësimin real të arritjeve të nxënësve.

Por, gjithësesi, duhet të pranojmë se vlerësimi në mësimin e gjuhës shqipe duhet të kalojë përmes komponentëve të mëposhtëm:

- \* *Vlerësimi përmes standardeve të arritjes;*
- \* *Vlerësimi i vazhdueshëm i nxënësve;*
- \* *Vlerësimi diagnostikues;*
- \* *Vlerësimi përmbledhës;*
- \* *Vlerësimi i punëve me shkrim;*
- \* *Vlerësimi i programit mësimor.*

**a) Vlerësimi përmes standardeve të arritjes** është një pretendim i një niveli të lartë, nga të cilat mësuesi dhe specialisti përcakton normat dhe kërkon që ato të arrihen nëpërmjet indikatorëve dhe testeve lokale e kombëtare në bazë shkolle të organizuara në periudha të caktuara.

**b) Vlerësimi i vazhdueshëm** i nxënësve synon të mbajë nën mbikqyrje përparimin e vazhdueshëm dhe hap pas hapi të nxënësve. Për realizimin e tij përdoren mënyra të ndryshme të tilla, si: nota, shënimet e vazhdueshme, listat e vëzhgimit për synime të caktuara, dosjet personale dhe forma të tjera që gjallërojnë punën e përditshme në klasë. Një nga karakteristikat më të rëndësishme të vlerësimit të vazhdueshëm është mbajtja gjallë dhe motivimi i nxënësve për progres në punën e tyre të përditshme.

**c) Vlerësimi diagnostikues** është një formë, e cila duhet të jetë në qendër të punës së mësuesit të gjuhës, pasi mësuesi, në këtë tip vlerësimi, shfaqet edhe si kërkues i dukurive të ndryshme gjuhësore. Atij i duhet të hulumtojë në të folurit, të shkruarit apo të lexuarit e nxënësve. Për këtë, ai përdor indikatorë të cilët i japin atij të dhëna të caktuara për atë dukuri, që interesohet, i përpunon të dhënat, i grupon dhe nxjerr përfundime. Me këtë lloj vlerësimi, mësuesi kërkon të njohë llojet më tipike të

gabimeve të nxënësve në drejtshkrim, pikësim etj. Shpesh indikatorët për këtë lloj vlerësimi mund të gjenden të gatshëm, por edhe mësuesi me përvojat e tij, krijon tipet e kërkuara dhe të nevojshme për vlerësimin e nxënësve.

*d) Vlerësimi përmbledhës* zakonisht realizohet përmes përdorimit të testeve të standartizuara dhe të miratuara nga shkolla, komuna, shteti. Testimi i parë kombëtar në lëndën e gjuhës shqipe kryhet në përfundim të klasës së tetë. Praktikrat e sotme po tregojnë se për qëllime të studime të një niveli edhe më të lartë (ndërkombëtar) po bëhen testime me karakter përmbledhës edhe në vite të ndërmjetme, në prerje ciklesh dhe për shprehje të caktuara, p.sh: “për shprehjet e të lexuarit”, “për shprehjet e të shkruarit”, “për shprehjet e gramatikës” etj.

*e) Vlerësimi i punëve me shkrim* është një moment shumë i rëndësishëm i njohjes së aftësive gjuhësore të nxënësve. Njohja e këtij niveli, tashmë, nuk mund të bëhet vetëm me rrugët praktike e tradicionalisht të njohura, si: korrigjimet nga mësuesi. Praktikrat e reja sot po rekomandojnë vendosjen e kriterëve dhe të standardeve të përshtatshme dhe të arritshme nga nxënësit. Kështu, duhen kërkuar forma të larmishme vlerësimi të cilat të pasqyrojnë nivelin real të arritjeve të nxënësve me qëllim marrjen e masave për përmirësimin e tij.

- Shënimet e mësuesit janë shumë të rëndësishme për vlerësimin e punëve me shkrim të nxënësve.

- Vlerësimi që nxënësit mund t'i bëjnë njëri-tjetrit është një moment i rëndësishëm që ndihmon mbarëvajtjen e punës në këtë drejtim.

- Hartimi i kriterëve të caktuara për vlerësimin e esëve mundëson vlerësimin real të tyre.

- Testi mësimor tashmë i mbështetur në kriterë shkencorë qartëson e saktëson vlerësimin e nxënësve.

- Dosjet e nxënësve për ruajtjen e punimeve me shkrim të tyre japin mundësi për vlerësime përmbledhëse dhe për njohjen rritëse të punimeve të tyre.

-Puna me projekte jep një informacion të qartë për formimin e nxënësve dhe për aftësitë e tyre kërkimore.